



Irma Shkrepa, MSc.

**Asistent Lektore
Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Irma Shkrepa është diplomuar në Bachelor në Menaxhim - Biznes, Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, si dhe certifikuar me gradë Post Universitare: “Specialiste e Lartë Banke” nga Universiteti i Tiranës, si dhe Master in Business Administration në “Banking and Corporate Finance” nga Kurt Bosch, Sion, Zvicër.

Zj. Shkrepa filluar karrierën e saj menaxheriale në moshën 24 vjeçare në sektorin bankar, pas një eksperience 2 vjeçare në të gjitha pozicionet e Bankës së Kursimeve; arkëtare, shërbim klientele, përgjegjëse operacionale, finance dhe prokurime, Drejtore Rajonale. Në Raiffeisen Bank ka qenë pjesë e stafit të lartë manaxherial në pozicionet: Drejtore e Zhvillimit të Biznesit & Menaxhere Projekti: “Efiçenca e Forcës së Shitjes”; Drejtore e Biznesit të Kredive Hipotekore; Drejtore e Shitjeve Direkte në Retailers dhe Zhvillimit të brokerimit ndërkombëtar dhe agjentëve referues.

Në 2010 ajo merr rolin e Drejtorit Ekzekutiv të NOA, njekohesisht dhe drejtuese e projektit “Phenix” për ndërtimin e modelit të biznesit hibrid financiar me asistencën e drejtuesve të GE Money Bank. Në vitin 2019 ka drejtuar kompaninë leasing “Mogo Albania” me qendër në Riga. Ajo ka drejtuar në fushën e hidrokarbureve kompaninë Gruppo API, franshizë për Ballkanin, Drejtore Retail në NEPUN

Zj.Shkrepa drejton aktualisht Institutin e Inxhinierisë Financiare për Banka dhe Sigurime (International Institute for Banking and Insurance IFIBI), ne rolin e Master Trainer, Loss adjuster dhe Konsulente. Ajo ka qenë këshilltare në Kabinetin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe më pas në Agjensinë për Bashkëqeverisje në Kryeministri, sikundër dhe është Eksperte e Sektorit Financiar në Deutsche Spakassenstiftung fur International Kooperation, si dhe konsulente për kompani ndërkombëtare si: BFC, Lloyds, Munich-re, Marsh Broker, Uniqa-re etc.

Aktualisht është pedagoge në Tirana Business University College dhe është e licencuar nga Raiffeisen International Academy si “Trajnuese” që certifikon aftësitë e saj për të transmetuar njohuri në përgjithësi dhe në shitje në veçanti. GIZ SANECA dhe ASPA për trajnimin e Kapitullit 9 të EU Acquis, Ambasada Amerikane si trajnuese e trajnerëve.